



BASHKIA FIER

Nr. 11812 Prot.
Dt. 17/09/2026

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK FIER
KRYESIA

Nr.

Fier në 16 . 09.2026

VENDIM NR. 09 DATË

PËR MIRATIMIN E RENDIT PARAPRAK TË DITËS PËR MBLEDHJEN E DATËS

Kryesia e Këshillit Bashkiak Fier në zbatim të Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr. 27 datë 15.04.2020 “ Për miratimin e rregullores së Këshillit Bashkiak, rregullores për Konsultimet Publike dhe Kodin e Sjelles për funksionimin e Këshillit”, Kreu 2, neni 22 “Kryesia e Këshillit “ neni 1, 3, 4

VENDOSI:

1-Miratimin e Rendit paraparak të Ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit Bashkiak, e cila do të zhvillohet në datën 24/09/2026 ora 12:00 . Bashkëlidhur këtij vendimi gjenden pikat e Rendit paraparak të Ditës.

2-Ngarkohet Sekretari i Këshillit Bashkiak për publikimin e njoftimit të Rendit të Ditës, si dhe njoftimin e Këshilltarëve, Kryetarit të Bashkisë dhe çdo personi tjetër të interesuar për pjesëmarrje në mbledhjen e Këshillit Bashkiak.

3-Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYESIA E KËSHILLIT

1-Melsi Bogdani

2-Arben Çuko

3-Fatbardha Merkaj

4-Marjus Voja

5-Kreshnik Dapi

6-Endri Jaupaj

7-Rrapi Gjika





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 11913 Prot.

Fier, më 17.09.2026

Lënda : Njoftim mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak.

Drejtuar: ANËTARËVE TË KËSHILLIT BASHKIAK FIER

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË FIER
PREFEKTIT TË QARKUT FIER**

Në mbështetje të nenit 53 pika 4, nenit 56 pika 2, shkronja "a", te ligjit 139/2015 "Per vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar dhe Rregullores së Këshillit Bashkiak neni 61, ju njoftojmë thirrjen e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak Fier në sallën plenare të këshillit, ditën e **Enjte, datë 24.09.2026 në orën 12:00** me këtë rend dite:

1. Miratimi i Rendit të Ditës.
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit datë **27.08.2026**.
3. Projektvendim Nr. 89 datë 16.09.2026 "Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin Gusht 2026."
4. Projektvendim Nr.83 datë 16.09.2026 "Për miratimin e kërkesës së Agjencisë së Zhvillimit të Territorit për dhënien e të drejtës së kalimit në pasurinë nr. 407 të ndodhur në zk. 3358, pronë e Bashkisë Fier, në funksion të miratimit të Lejes së Ndërtimit për objektin "Ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet të instaluar 10 MW dhe veprave ndihmëse" me subjekt zhvillues shoqërinë "Gemtech Albania" sh.p.k."
5. Projektvendim Nr. 87 datë 16.09.2026 "Për përcaktimin e formës së kalimit të kontributit prej 3% të sipërfaqes ndërtimore për fondin publik të banesave sociale, nga subjekti "NBA Cotto" shpk, në sipërfaqe ndërtimi (metër katror) ose në vlerë monetare (lekë)".

6. Projektvendim Nr.85 datë 16.09.2026 “Për një ndryshim (rishpërndarje fondesh) në VKB nr. 118, dt 11.12.2025 «Për miratimin e PBA 2026-2028 dhe buxhetit të vitit 2026”, i ndryshuar.
7. Projektvendim Nr.86 datë 16.09.2026 “Për Miratimin e Dokumentit të Programit Buxhetor Afat Mesëm (PBA) 2027-2029 të Bashkisë Fier”, Faza e II.
8. Projektvendim Nr. 88 datë 16.09.2026 “Për rilidhjen e kontratës së shitjes së truallit në praninë e noterit, për efekt të regjistrimit në regjistrin e pasurive të paluajtshme pranë Agjencinsë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, me shtetasin Mystehak Pashaj”
9. Projektvendim Nr.84 datë 16.09.2026 “Për dhënien ose jo të pëlqimit në parim për vijimin e procedurave të negociimit për zhvillimin dhe shkëmbimin e pasurisë nr. 10/546 zk. 8533, në pronësi të Bashkisë Fier, pasurisë nr. 2/118 zk. 8534 dhe pasurisë nr. 6/178 zk. 8533, prona shtetërore në administrim të Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Fier”.
10. Projektvendim Nr.90 datë 16.09.2026 “Per miratimin e projekt-zbatimit te zgjerimit te urës ekzistuese mbi kolektorin Roskovec-Hoxharë (vija e Ngjalës), lagja “ Sheq i Madh”, Fier”.
11. Projektvendim “Për dhënie ndihme shtetërore financiare për familjen e shtetasit Agron Kalemaj, lagjja “Liri”, Njësia Administrative nr.2, dëmtuar nga zjarri i datës 22.08.2026, familjen e shtetasit Arben Kondakciu, fshati Verri, Njësia Administrative Mbrostar Ura, dëmtuar nga zjarri i datës 04.09.2026, familjen e shtetasit Luan Isufaj, lagjja “Sheq i Madh”, Njësia Administrative nr.2, dëmtuar nga zjarri i datës 04.09.2026”.
12. Projekvendim Nr.92 datë 17.09.2026 “Për një shtesë dhe ndryshim në VKB nr. 109, datë 27.11.2025, “Mbi strukturën, nivelin e taksave dhe tarifave vendore të Bashkisë Fier për vitin 2026”, i ndryshuar.”
13. Propozim “ Për dhënien e titullit Qytetar Nderi për shtetasit Agron Profka, Jorgaq Angjeli dhe Zenel Manari.”

Informacion Këshillit : “Mbi Raportin e Monitorimit 8-mujor të zbatimit të Buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026” si dhe mbi materialet e propozuara për nxjerrje jashtë përdorimit gjatë hartimit të pasqyrave financiare të vitit 2025.

KRYETAR KËSHILLIT

MELSI BOGDANI

